



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbali i dëgjimit publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 në fshatin Kërpimëh

Drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, hapi dëgjimin publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027, në fshatin Kërpimëh, ku mori pjesë edhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Bahri Selimi.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani tha se “Korniza Afatmesme Buxhetore hartohet duke u bazuar në Qarkoren e Parë Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave për të gjitha organizatat buxhetore përfshirë edhe komunat në nivel të Republikës së Kosovës, dhe këtu përcaktohen limitet buxhetore për organizatat buxhetore të cilat kanë projeksionet buxhetore të Ministrisë së Financave, ne sot jemi këtu të marrim kërkesat dhe propozimet e juaja në mënyrë që gjatë hartimit të KAB, të jemi sa më gjithëpërfshirës në realizimin e kërkesave së qytetarëve, duke pasur parasysh që gjithmonë kërkesat e juaja janë më të mëdha se mundësitë buxhetore, por ne do të prioretizojmë ato në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë qytetarë.

Komuna e Podujevës për këtë vit e ka një buxhet afër 31 milion euro, në bazë të Qarkores së Parë Buxhetore është një lajm i mirë që do të kemi një rritje të buxhetit, prej përafërisht 2.6 mil euro dhe normalisht kjo rritje shpërndahet në paga, në komunal, në subvencione, mallra dhe shërbime por edhe në investime kapitale (ku këtu pritet të kemi një rritje rreth 1 mil euro)

Ju lutem fjala është e juaja”tha drejtori Osmani.

Banor i fshatit Kërpimëh- tha së është shumë e nevojshme rinovimi i shkollës së fshatit, sepse është objekti actual është mjaft i vjetër dhe po krijon vështirësi në procesin e mësimin. Kërkesë tjetër kishte edhe ndërtimin e një salle të edukatës fizike.

Bahri Kastrati- kërkoi ndërtimin e e murit mbrojtës te lumi i Pakashticës, rregullimin e lumit Llap.

Mehmet Dibrani – Theksoj si nevojë ndriqimin publik në disa rrugë dhe rregullimin e hapësirës, largimin e objekteve të vjetra të kooperativës bujqësore.

Jashar Babatinca- tha se është e nevojshme ndërtimi i disa rrugincave në fshatin Këprimeh.






Ndërsa drejtori Osmani dhe drejtori Selimi dhanë disa shpejgime sa i përket problemeve me rregullimin e lumit Llap, ndërkaq u zotuan që brenda mundësive buxhetore kërkesat e tyre do t'i inkuadrojnë në Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

7 Qershor- Podujevë



Lista e pysemaneve

07.06.2024
Këpimeli, Podujevë
Kohiza Afatmesme
Buxhetore 2025-2027

1. Jani Probitina 
2. Hava Gashi 
3. Bahri Kastrati 
4. Mehmet Sibrani 
5. Jasgar Babatiq 
6. 